



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 27
07.12.2018

NR. VENDIMI 26
21.12.2018

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE - MILIANA MUÇA

asistuar nga sekretare seance gjyqësore Alma Ramaj, sot në dt.21.12.2018, ora 09:31 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën me nr.regj. themeltar 27, datë 07.12.2018, që i përket:

KËRKUES: 1. P. M., i biri i A. dhe dhe i Rr., datëlindja ., lindur në xxxx, banues në xxxx, shtëpi private, i përfaqësuar me deklaram në seancë gjyqësore nga avokati A. K., Dhoma e Avokatisë xxxx, me numër liçense xxxx dhe nipt xxxx.

2. M. B., i biri i N. dhe dhe i D., datëlindja xxxx, lindur në xxxx, mbanues në xxxx, i përfaqësuar me prokurë nga E. B. dhe me deklaram në seancë gjyqësore prej kësaj të fundit nga avokati A. K., Dhoma e Avokatisë xxxx, me numër liçense xxxx dhe nipt xxxxx.

3. L. M., i biri i H., datëlindja xxxx, i përfaqësuar me prokurë nga avokati A. K., Dhoma e Avokatisë xxxx, me numër liçense xxxx dhe nipt xxxx.

PERSONA TË INTERESUAR: 1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfaqësuar nga prokurori Edvin Kondili.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në mungesë.

OBJEKTI: Heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin xxxx datë xxxx, pika x të Gjykatës për Krime të Rënda, pika x.

BAZA LIGJORE: Neni 274 pika 3 i K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuessve dhe dëgjoi palët në konkluzione përfundimtare që kërkuar:

Kërkuesit, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre: Pranimin e kërkesës sipas objektit.

Prokurori rrëzimin e kërkesës,

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në mungesë.

VËREN

Kërkuesit P. M., M. B., L. M. i janë drejtuar Gjykatës për Krime të Rënda më datë xxxx duke kërkuar heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin xxx datë xxxx të Gjykatës për Krime të Rënda, duke e bazuar këtë kërkesë në nenin 274 pika 3 të K.Pr.Penale.

I. Rrethanat e faktit

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i ka paraqitur kësaj gjykate më datë xxxx kërkesën në zbatim të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” për një sërë pasurish në pronësi, administrim apo në posedim të subjekteve **Sh. Ç.** (Sh. Sh.); **V. Ç.** (V. Sh.), **A. Ç.** (A. Sh.), **J. Ç.**, **Xh. T.**

Në datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr.xxx, ndaj këtyre subjekteve.

Regjistrimi i këtij procedimi është bërë mbi bazën e informacionit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxxx, ardhur me shkresat nr.xxx prot, datë xxxx dhe nr.xxxx prot, datë xxxx.

Rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, mbi bazën e referimit të kryer nga Drejtoria Vendore e Policisë xxxx, ka regjistruar procedimin penal nr.xxxx të vitit xxxx për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndaj shtetasve Sh., V., A., J. Ç., Xh. T. dhe dy personave juridik, subjekteve tregtare “xxxx” shpk dhe “xxxx” shpk.

Nga veprimtaria hetimore paraprahe si dhe nga informacioni i mbledhur dhe i ardhur në mënyrë shkresore nga institucionet kompetente, ka rezultuar e provuar se:

Vëllezërit Sh. e V. Ç. janë të përfshirë në aktivitete kriminale, për të cilat janë dënuar në Shqipëri, Belgjikë dhe Greqi. Pretendohet se mbi dyshime të bazuara, vëllezërit Ç. janë të përfshirë në krimin e shfrytëzimit të prostitucionit në mënyrë të vazhdueshme në disa vende të Bashkimit Evropian, parashikuar nga neni 114 i K.Penal, në “Vjedhje” parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal, “Trafikimit të mjeteve motorike”, parashikuar nga neni i 141/a K.Penal, “Tregtimit të mallrave kontrabanda dhe për mallra aksize”, parashikuar nga nenet të 173 dhe 174 K.Penal, për veprën penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i K.Penal dhe për vepra penale të tjera.

Pikërisht të ardhurat e realizuara nga këto veprimtari kriminale, të kryera në mënyrë të pandërprerë, i kanë investuar në pasuri të paluajtshme e të luajtshme, duke qarkulluar para në sistemin bankar, si dhe duke injektuar para të rrjedhura nga veprimtaria e tyre kriminale edhe në dy shoqëritë “xxxx” sh.p.k dhe “xxxx” sha të themeluara po prej tyre dhe prej të afërmeve. Për këto fakte janë administruar aktet e vëna në dispozicion nga autoritetet e drejtësisë së shtetit xxxx, ku rezulton se provohet: Shtetasit shqiptarë **A. Gj., Ll. Ll.** (Alias Ll. Sh.) (Alias N. J.) (Alias Sh. Sh.), **E. Ç.** (Alias E. Sh.a) lindur në datë xxxx, **Sh. Sh.** (Alias Sh. Ç.) (Alias Sh. G.), janë hetuar dhe gjykuar nga Gjykata e Apelit xxxx, Dhoma nr.xxx me vendimin nr.xxxx nga Prokuroria dhe me nr.xxx i vendimit, e cila ka gjykuar apelin kundër vendimit datë xxxx të Gjykatës së Shkallës Parë xxxx, dhoma x.

Konkretisht, referuar këtij vendimi: shtetasi Sh. Sh. është deklaruar fajtor për faktet e provuara kundër tij, konkretisht për faktet xxxx dhe x.

Fakti A2 - Të tre të pandehurit kanë përvetësuar një automjet xxxx me vlerë xxxx euro.

Fakti A3 – Ll. Ll. (Alias Ll. Sh.) (Alias N. J.) (Alias Sh. Sh.), E. C. (Alias E. Sh.) lindur në datë xxxx, Sh. Sh. (Alias Sh. Ç.) (Alias Sh. G.), kanë falsifikuar dhe përvetësuar në bashkëpunim një automjet xxxx në vlerë totale prej xxxx euro.

Fakti C2 - Të katër shtetasit e akuzuar kanë përvetësuar, konvertuar dhe transferuar vlera e sende dhe konkretisht automjetin me xxxx me një vlerë xxxx euro datë xxxx. **Fakti C3** – Ll. Ll. (Alias Ll. Sh.) (Alias N. J.) (Alias Sh. Sh.) E. C. (Alias E. Sh.) lindur në datë xxxx dhe Sh. Sh. (Alias Sh. Ç.) (Alias Sh. G.) në bashkëpunim kanë përvetësuar transferuar konvertuar në vlerën prej xxxx euro automjetin xxxx në Shtator të vitit xxxx.

Fakti G – Sh. Sh., akuzohet (faqe x e vendimit paragrafi x) se ka bërë të zakonshëm shfrytëzimin e prostitucionit në dëm të E. C. në mënyrë të vazhdueshme deri në xxxx.

Në vijim, nga kthim përgjigjet nga autoritetet e drejtësisë së shtetit xxxx rezulton se shtetasit Sh. Sh., M. Sh., V. Sh., L. Sh. dhe një person tjetër, janë dyshuar se, në shtetin xxxx, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë organizuar një rrjet të shfrytëzimit të prostitucionit si dhe janë dyshuar edhe për vrasjen e njerës prej femrave që shfrytëzonin, konkretisht për ngjarjen e ndodhur në datë xxxx ku ka gjetur vdekjen, si pasojë e dhunës së të dyshuarve, shtetësja N. H., e cila kishte shkuar në vitin xxxx në xxxx së bashku me Sh. Sh.. Për këtë ngjarje ka patur urdhër arresti me nr.xxxx, datë xxxx për shtetasin Sh. Sh.. Me vendimin nr.xxxx të Këshillit të Gjykatës së Fajeve xxxx është gjykuar çështja me të pandehur Sh. Sh., M. Sh., V. Sh., L. Sh. dhe më pas çështja iu ka kaluar autoriteteve të drejtësisë shqiptare nëpërmjet transferimit të procedimit penal. Me vendimin nr.xxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx,

shtetasi Sh. Ç. së bashku me vëllanë e tij, shtetasin M. Ç. janë dënuar për veprat penale të “Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese”, kryer në bashkëpunim dhe “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër”. Kundër vendimit është ushtruar ankim, dhe me vendimin nr.xxxx, datë xxxx, të Gjykatës së Apelit xxxx, shtetasit Sh. Ç. i është pushuar çeshtja penale, bazuar në nenin 328/dh të K.Pr.Penale me arsyetimin se nuk rezulton të jetë bashkëautor në veprat penale për të cilat është akuzuar, ndërsa për shtetasin M. Ç. është lenë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, dënuar me xx vjet burgim, për veprën penale të vrasjes (pa bashkëpunim) dhe “Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese”. Në kuadër të këtij gjykimi, rezulton se nga data xxxx - xxxx e më pas nga data xxxx -xxxx, kur Sh. Ç. është shpallur i pafajshëm me vendimin nr.xxxx të Gjykatës Apelit xxxx, ai ka qëndruar në paraburgim, dhe kjo rrethanë kjo e evidentuar nga prokurorja në kërkesën drejtuar gjykatës si e tillë që provon se ai nuk ka siguruar asnjë të ardhur gjatë kësaj periudhe.

Me vendimin nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës Shkallës Parë xxxx, shtetasi V. Ç. është dënuar për veprat penale të “Vjedhjes”, “Përvetësimi i sendeve të vjedhura”, parashikuar nga neni 287/b dhe 134/2 të K.Penal. Në datë xxxx V. Ç. procedohet për veprat penale të “Kontrabandë me mallra të tjera” parashikuar nga neni 174 K.Penal dhe “Kontrabandë me mallra akcize” parashikuar nga neni 173 K.Penal. Në datë xxxx ka filluar procedimi për evasion fiskal për shoqërinë e tij “xxxx” sh.p.k.

Në datë xxxx ka filluar hetimi ndaj Sh. Ç., përfaqësues i firmës “xxxx” sh.p.k.

Hetimi është përqëndruar tek personat e afërm të shtetasve Sh. dhe V. Ç. dhe referuar çertifikatës së përbërjes familjare, janë hetuar pasuritë e shtetasve: M. Ç. (vëllai), V. Ç. (motra), E. Ç., E. S., A. Ç., J. Ç., M. S..

Argumentat drejtuar Gjykatës për Krime të Rënda për vendosjen e një mase provizore, asaj të sekuestros në zbatim të ligjit 10192 datë 03.12.2009, rezultojnë dhe të njëjtat argumenta me të cilat Prokuroria xxxx i është drejtuar dhe i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx që në kuadër të procedimit penal të regjistruar pranë prokurorisë xxxx, të vendoset sekuestro preventive për efekt të procedimit penal për pasuritë që i përkasin apo që janë në zotërim të të hetuave për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Me vendimin Nr.xxxx, datë xxxx Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx ka vendosur sekuestro preventive pasuritë e luajtshme/te paluajtshme të shtetasve Sh., V., A. dhe J. Ç. dhe të dy shoqërive dhe pikërsht mbi ato pasuri të cilat dhe kanë qenë dhe objekt kërkimi i prokurorisë për Krime të Rënda për vendosjen e masës parandaluese në zbatim të ligjit 10192 datë 03.12.2009, duke u vendosur nga kjo gjykatë sekuestro me vendimin nr. xxx datë xxxx.

Njëra ndër pasuritë e sekuestruara rezulton të jetë dhe pasuria **nr.xxxx**, zk.xxxx, vol.xx, fq.xxx, e llojit **xxxx**, me sip.xxxx m², në emër të xxxx xxx, pasuri mbi të cilën ngrenë pretendime pronësie kërkuesit duke iu drejtuar kësaj gjykate për heqjen e saj.

Në dizpozitiv të këtij vendimi gjykata në pikën IV. është shprehur:

Urdhërohet pezullimi i pasojave të zbatimit të masës të sekuestrimit, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e masës së sekuestrimit të vendosur për llogari të procedimit penal nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx.

II. Pretendimet e palëve

Përfaqësuesi i kërkuesve, si në kërkesën drejtuar gjykatës ashtu dhe në seancë gjyqësore parashtrori se kërkuesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e xxxx dhe më datë xxxx, në dyqanet e tyre të shtrira në pasurinë në fjalë është paraqitur oficeri i policisë gjyqësore dhe ia ka sekuestruar pasurinë. Nga ky sekuestrim kanë kaluar mbi shtatë muaj. Kërkuesit P. i kanë sekuestruar ambjentin prej xxx m², të ndarë në x ambjente biznesi, kërkuesit M. B. ambjentin prej xx m² dhe kërkuesit L. M. ambjentin prej xxx m², të x këto pasuri të shtrira në pasurinë nr.xxxx zona kadastrale xxxx xxxx. Këto sekuestro janë vendosur për llogari të vendimit nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit xxxx, bazuar në nenin 274 të K.Pr.Penale.

Këto pasuri janë sekuestruar dhe për llogari të vendimit të Gjykatës për Krime të Rënda nr.xxx, datë xxxx, pika 22 (i referohen lidhur me numrin rendor pjesës hyrëse të vendimit).

Kërkuesve iu është cënuar e drejta e pronësisë pasi ata i kanë blerë këto pasuri me të ardhurat e realizuara nga emigracioni dhe kjo provohet nga faturat përkatëse që i janë bashkëngjitur kërkesës. Nga Agjencia e Sekuestrimit dhe Konfiskimit të Pronave të Sekuestruara janë lidhur kontrata qiraje për objektet e tyre, duke përfituar qiranë agjencia. U paraqitën si prova kontratat e emërtuara kontrata shitje të një sendi në të ardhmen për secilin nga kërkuesat me cilësinë e blerësve dhe shoqërisë “xxxx” më cilësinë e shitësit.

Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i kërkuesit sqaroi se të njëjtën kërkesë e ka të paraqitur dhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx dhe çështja është ende në proces, por e ka paraqitur dhe pranë Gjykatës për Krime të Rënda duke qenë se është vendosur një sekuestro e dytë nga kjo e fundit. Gjithashtu pretendoi se kërkuesat nuk janë thirrur ende për t’u pyetur nga prokuroria lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurije. Sipas tij, këto të ardhura janë të ligjshme, të krijuara nga puna në emigracion. Kontratat megjithëse emërtohen nga noteri me rezervë pronësie, janë kontrata pronësie, pasi hipoteka nuk duhe të lëshonte vërtetim hipotekor për kompaninë xxxx shpk.

Prokurori pretendoi se kërkesa duhet rrëzuar, pasi sekuestroja është vendosur në zbatim të ligjit 10192 datë 03.12.2009 dhe jo të K.Pr.Penale. Sipas dispozitave të këtij ligji, kërkuesit konsiderohen persona të lidhur pasi kanë lidhur kontrata shitje me rezervë prone dhe duhet hetuar burimi i krijimit të të ardhura që iu kanë shërbyer për të kryer pagesa në favor të xxxxx. Procedimi penal vijon ende dhe pasojat e vendimit të dhënë nga Gjykata për Krime të Rënda janë të pezulluara deri në revokimin apo shuarjen e masës së sekuestrimit të dhënë për llogari të procesit penal nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx.

Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

(vlerësuar dhe thirrur nga gjykata me cilësinë e palës së interesuar), u përcoll informacioni me shkresën nr.xxxx, datë xxxx, sipas të cilës janë marrë në administrim të gjitha pasuritë e sekuestruara me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx dhe Gjykatës për Krime të Rënda. Lidhur me pasuritë e kërkuara për t'u hequr sekuestroja (gjykata i kam bashkëngjitur kërkesën e kërkuarëve) informohet që gjatë marrjes në dorëzim të pasurive, pasuria nr.xxxx e llojit godinë, kati i parë, dyqane në pronësi të "xxxx" x, kishte rezultuar që kati i parë ka qenë i shitur tek të tretë dhe pronarët kanë refuzuar ti dorëzojnë objektet e dhëna me qira. Iu është lënë kohë që pronarët të bëjnë ankesë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx. Qiratë arkëtohen për llogari të xxxx dhe kur gjykata të heqë sekuestron shumat e arkëtuara i kthehen pronarëve të ligjshëm.

Gjithashtu pretendohet se agjencia është vetëm pjesë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara dhe jo pjesë e bllokimit të tyre.

Bashkëngjitur, në mbështetje të qëndrimit të saj mbi rolin që ajo ka në këtë proces është dhe vendimi nr.xxxx, datë xxxx. Rezulton se shtetasi S. T. ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx kërkesën për kundërshtimin e sekuestros së një sërë pasurishë të sekuestruara me vendimin nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, dhe kërkesa e tij është rrëzuar.

II. Vlerësimi i gjykatës

Kërkesa e kërkuarëve P. M., M. B., L. M. duhet rrëzuar si e pabazuar.

Sikurse rezulton Gjykata për Krime të Rënda ka vendosur në zbatim të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", duke sekuestruar, me kërkesën e Zyrës së Prokurorisë pranë saj, pasuritë e subjekteve për të cilët dhe është regjistruar hetimit pasuror, për pasojë dhe për pasurinë ku ngrenë pretendime kërkuarës.

Në këtë vendim, është arsytuar:

" Pavarësisht faktit që për efekt të një procedimi penal ndaj po këtyre pasurive është vendosur masa e sigurimit me karakter pasuror e sekuestros preventive nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese" me ligjin nr. 70 datë 27.4.2017, ka gjetur rregullim marrëveshje me procedimin penal. Dhe konkretisht në nenin 5 parashikohet se procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji dhe të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj. Në pikën 3 parashikohet që në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen kundër pasurisë".

Në këtë mënyrë rezulton që gjykata të ketë disponuar dhe në dispozitiv të vendimit. Rezulton se procedimi penal vijon ende dhe nuk ka ndonjë vendim për revokimin apo shuarjen e sekuestros së dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx. Ndodhur në këto kushte pasojat e zbatimit të vendimit nr.xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë të pezulluara.

Theksohet se Gjykata për Krime të Rënda ka disponuar me vendimin e kundërshtuar nga kërkuesat për të gjitha pasuritë, përfshirë dhe pasuritë e pretenduara, jo në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale (ku referojnë kërkesat), por në bazë të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese” dhe procedimi penal dhe ai pasuror veprojnë të pavarur nga njëri tjetri dhe rregullime ligjore tërësisht të ndryshme.

Ndryshe nga ai penal që drejtohet kundër personit, procedimi pasuror, ndrejtohet kundër pasurisë së të dyshuarit/dyshuarve për njërën apo disa prej veprave penale specifike të parashikuara në këtë ligj (nuk drejtohet kundër personit, apo autorit). Qëllimi i ligjit është aplikimi i masave parandaluese në lidhje me pasurinë në pronësi apo në zotërim të tyre.

Fusha e zbatimit të këtij ligji, referuar nenit 3, përfshin:

1. Pasuritë e personave për të cilët ka një **dyshimi të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në listen e veprave penale që gjejnë pasyrim në nenin 3 të këtij ligji (pika 1).**

2. Pasuritë e personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta (pika 2.a).

3. Pasuritë e personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre (pika 2.b).

Ndërsa në pikën 4 po këtij neni saktësohet se ligji është i zbatueshem edhe për pasuritë e personave, te krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë të vendosura për shprehje të dyshuar të tij në veprimtari kriminale, sipas këtij ligji.

Neni 11 i ligjit parashikon kriteret mbi të cilat gjykata vendos sekuestrimin e pasurisë si njëra prej masave parandaluese (të përcaktuara në nenin 4, që janë sekuestrimi dhe konsfiskimi).

Kjo gjykatë konstaton referuar provave të paraqitura nga përfaqësuesi i kërkuesve që vendimi me të cilin është vendosur sekuestroja nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx është bërë objekt ankimi dhe në Gjykatën e Apelit xxxx, e cila me vendimin nr.xxx, datë xxxx ka rrëzuar kërkesën e tyre, duke miratuar masën e sekuestros së vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx dhe për pasuritë e poseduara nga kërkuesit. Arsyetohet në vendimin e Gjykatës së Apelit që kërkuesit (rezultuar ankimes të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx) nuk çënohen në interesat e tyre për shkak se kontratat noteriale të paraqitura prej tyre nuk përbëjnë mënyrë fitimi pronësie pasi janë kontrata të shitjes së sendit në të ardhmen.

E njëjta kërkesë, sikurse kërkesa objekt gjykimi dhe me të njëjtat shkaqe, është paraqitur dhe është ende në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, si gjykata që ka marrë vendimin që ka efekte aktualisht në drejtim të sekuestrimit të pronës së pretenduar nga kërkuesat, përsa kohë nuk ka ende një vendim për revokimin apo shuarjen e sekuestros së vendosur për llogari të procedimit penal, si masë sigurimi “sekuestro preventive”. Kjo në kushtet kur pasojat e vendimit të marrë nga Gjykata për Krime të Rënda në zbatim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese” janë të pezulluara.

Mbi këto argumenta, gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesve, e bazuar në dispozitat e K.Pr.Penale dhe teksta pasojat e vendimit nr.xxx, datë xxxx të Gjykatës për Krime të Rënda janë të pezulluara, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE.

Gjykata, bazuar në ligjin nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dispozita tranzitore, pika 4 e ligjit nr.70/2017,

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesve P. M., M. B., L. M. me objekt heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin nr.xxx, datë xxxx, pika x (referuar pjesën hyrëse të vendimit) të Gjykatës për Krime të Rënda.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Urdhërohet sekretaria gjyqësore t’i dërgojë një kopje të këtij vendimi Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
4. Kundër këtij mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

U shpall në Tiranë në dt.21.12.2018, ora 10:29.

SEKRETARE
ALMA RAMAJ

GJYQTARE
MILIANA MUÇA

